

Emri i Lëndës : Gjuhë Shqipe I

Kodi	Tipi i lëndës	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
ALB 101	B	1	4	0	0	4.00	5
Lektori dhe orari i konsultimeve			Ana Cuka, Msc				
Asistenti dhe orari i konsultimeve							
Gjuha e kursit			Albanian				
Niveli i lëndës			Bachelor				
Përshkrimi			Gjuha është një element shumë qendror në jetën e njeriut. Ajo ndihmon si realizimin e komunikimit, ashtu edhe formësimin e mendimit dhe transmetimin e tij. Për këtë arsye, një përdorim i saktë dhe sa më i mirë i gjuhës na ndihmon si në procesin e njohjes, ashtu edhe në vetë prezantimin e personalitetit tonë. Ky kurs synon t'i aftësojë studentët me një përdorim korrekt dhe sa më të mirë të shqipes, të përmirësojë aftësitë e tyre në shkrimin e shqipes dhe t'i ndihmojë në ndërtimin e një ligjërimi të rrjedhshëm.				
Objektivat			<ul style="list-style-type: none"> •Të njihet studenti me rregullat themelore të artit të të shkruarit. •Të përvetësohen çështje të normës morfologjike dhe sintaksore. •Të arrijnë studentët një akt të lartë komunikativ, nëpërmjet ligjërimin normativ. •Të bëjnë punime me nivel të lartë gjuhësor (ese, detyra kursi dhe punim diplome). •Të nxitet të vështruarit kritik dhe akti i korrektimit në rastet e devijimeve nga shqipja standarde. 				

Programi i Lëndës

Java	Tema
1	Arti i të shkruarit. - Rregulla të krijimit. Fazat e krijimit (Planifikimi shkrimit , shkrimi i krijimit, rishkrimi).
2	Shkrimi i krijimit - Teksti, lidhëzat e tekstit, paragrafi, citimet dhe shënimet, përgatitja për shtyp e një dokumenti.
3	Rishkrimi - Redaktimi dhe korrektimi. Redaktimi. Korrektimi. Shenjat e korrektimit. Huazimet.
4	Normat e shqipes standarde. Shprehitë e të shkruarit drejt.
5	Emri - Gjinia, trajta dhe rasa e emrit. Përdorimi i emrave të përveçëm. Shumësi i emrave.
6	Gabimet në shkrimin e trajtave të emrave, shumësit të emrave. Rregulla të formimit të shumësit të emrave. Trajtat normative të shumësit.
7	Përemri - Llojet e përemrave. Lakimi i përemrit vetor dhe pronor. Trajtat e shkurtra të përbëra. Drejtshkrimi i trajtave të përbëra.
8	Provimi gjysmëfinal.
9	Folja - Klasat e foljeve. Prejardhja e formave foljore. Rregulla të drejtshkrimit. Mënyra urdhërore e foljes.
10	Çështje sintaksore - Rendi i gjymtyrëve në fjali. Përshtatja e kallëzuesit me kryefjalën. Rendi i përcaktorëve të emrit.
11	Përshtatja e përcaktorëve me emrin. Përshtatja e kohëve në periudhën me nënrenditje.
12	Mënjanimi i ndërtimeve të huaja në ligjërimin e shkruar dhe në të folur. Shprehje parafjalore të huaja dhe zëvendësimi i tyre me mjetet e shqipes.
13	Pastërtia e leksikut. Miqtë e rremë ((gr. παρόνυμ- paronimet).
14	Shëmtimet e gjuhës dhe fjalët e përdorura me kuptime të gabuara.
15	Ndërtimet foljore të huaja. Fjala shqipe në vend të fjalës së huaj. Rregulla të drejtshkrimit të emrave me prejardhje të huaj.
16	Provimi Final
Parakushtet	

Literatura	<ul style="list-style-type: none"> • Rami Memushaj, Shqipja standarde, Toena, Tiranë, 2002. • Bahri Beci, Gramatika e gjuhës shqipe për të gjithë, Tiranë: Botimet EDFA, 2004.
Referenca të tjera	<ul style="list-style-type: none"> • Gjovalin Shkurtaj, Kultura e gjuhës, Tiranë: SHBLU 2006. • Shaban Demiraj, Prejardhja e shqiptarëve nën dritën e dëshmimeve të gjuhës shqipe, Tiranë: shtëpia botues "Shkenca", 1999 • Eqrem Çabej, Hyrje në historinë e gjuhës shqipe, Tiranë: Çabej, 2008. • Drejtshkrimi i gjuhës shqipe, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Tiranë: 1973
Punë laborator	
Përdorimi i komp.	
Të tjera	

Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat

1	Studentët do të jenë të aftë të përkthejnë dhe përshtasin më mirë nga gjuhët e huaja tekste të ndryshme, duke njohur më në hollësi gjuhën amtare.
2	Studentët do të jenë të aftë të shkruajnë krijime, ese, artikuj shkencorë etj. duke siguruar kohezionin dhe koherencën gjatë shkrimit.
3	Studentët do të pajisen me njohuritë bazë të rregullave të drejtshkrimit, për t'i aftësuar në përdorimin e saktë të shqipes në ligjërimin e shkruar dhe në atë të folur.

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës

Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja
Gjysmë finale	1	30
Kuize	1	10
Projekte	0	0
Projekte semestrare	0	0
Punë laborator	0	0
Pjesëmarrja në mësim	1	10
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final		50
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final		50
Total		100

Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)

Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	4	64
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	2	28
Detyra	0	0	0
Gjysmë finale	1	10	10
Provimi final	1	20	20
Të tjera	1	5	5
Ngarkesa totale e orëve			127
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			5,08
ECTS			5